

VARIACIONE ETNOLOGJIKE/FOLKLORIKE (MES RETROSPEKTIVËS DHE PERSPEKTIVËS SË NJË DISIPLINE)

IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit, Shkup

Email: izaim_murtezani@yahoo.com

Përmbledhje

Në fokusin e këtij punimi shkencor janë problemet me të cilat ballafaqohen folkloristika dhe etnologjia në kuadër të zhvendosjes së interesimit të tyre nga lënda tradicionale në atë bashkëkohore. Këto dy disiplina, të veneruara si dije të kulturologjisë empirike, në kontekste të sotme kohore, veç tjerash, merren me probleme që kanë të bëjnë me transformimin e kulturës popullore, përkatësisht ndryshimit dhe dinamikës së saj si rrjedhojë e krijimit të përvojave të reja në çdo segment të jetës. Hulumtimi empirik i kulturës popullore, mes tjerash, në epiqendër të tij, gjithnjë e më shumë, i ka mediumet, përkatësisht komunikimin medial, por jo të veneruar nga këndi faktografik, por nga ai problemor. Tanimë, një ndër studiuesit e njohur Burdja, është i njohur me thënien se televizioni si një ndër mediumet më dominuese të kohës sonë, vazhdon të ushtrorë ndikimin e tij në krijimin e gjedheve të caktuara, apo të gatshme të sjelljes sonë, gjë që detyroi Finkelkrotin të vë në zbatim shprehjen “disfatë e mendimit”. Nëse folklori mbijeton në saj të komunikimit në relacionin mes individit dhe audiencës, atëherë një formë e re e tillë e komunikimit në përmasa gjithnjë e më të shumta në shoqërinë tonë, është edhe interneti që tanimë paraqet materje joshëse për shumë studiues të sferës folklorike/etnologjike.

Etnologjia/folkloristika bashkëkohore duhet të nënkuptohet si shkencë që synon studimin e kulturës dhe simboleve kulturore, pastaj proceseve kulturore dhe qytetëruese që ndodhin në kuadër të një grupi etnik, por edhe në grupe të ndryshme njerëzore dhe shtresa shoqërore, në të cilat, fenomenet kulturore gradualisht ndryshohen, gërshetohen, mbijetojnë ose zbehen krejtësisht. Në këto rrethana, çështja e internetit, kiber-kulturës, realitetit virtual, identitetit kulturor, proceseve etnike etj., sidomos në shoqëritë

passocialiste, ndoshta edhe më shumë pritet të marrin hov në të ardhmen si rrjedhojë e integritit gjithnjë e më të madh në rrjedhat e globalizmit. Studimi i kulturës popullore, patjetër të orientohet në problemet e masës, përkatësisht njeriut. Kujt i duhet etnologjia, pyeste disa vite më parë studiuesi Diter Kramer duke nënvizuar synimin që kjo disiplinë patjetër të jetë relevante në aspektin shoqëror.

Fjalë kyçe: folklor / etnologji, kulturë, identitet, transformim, televizion, internet, globalizëm, mit, ritual, traditë, folklor, tranzicion, komunikim, simbol, etj.

Hyrje

Folkloristika dhe etnologjia si disiplina simotra që merren me studimin e kulturës popullore në përgjithësi, nuk mund të lavdërohen se kanë ndonjë jetë të gjatë në skenën e shkencave shoqërore, apo humane, edhe pse lënda, apo materja e tyre, është aq e lashtë sa është e lashtë edhe vetë qenia njerëzore. Kjo nuk do të thotë se ato nuk kanë një parafillesë të tyre e cila shtrihet edhe në kohët më të hershme, kurse për këtë më së miri flet libri i Gjuzep Kokjarës në të cilin jepet një pasqyrë e gjerë e rrugëtimit të këtyre disiplinave në Evropën Perëndimore (Kokjara, 1985). Ndërkaq, periudha e cila u jep shtytje më të guximshme shkencave në fjalë me ç’rast fillon të ravizohet më qartë objekti i tyre studimor, është gjysma e dytë e shekullit XIX kur ndodhin ndryshime të mëdha në të gjitha sferat e jetës, e sidomos ndryshimet që ndodhin me lëvizjen e re që u paraqit si proces i natyrshëm i ndryshimeve rrënjësore politike dhe shoqërore në Evropë kah fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX. Këto ishin momente kur borgjezia e rrëronte rendin shoqëror feudal, atëherë edhe kur filloi “rilindja” letrare, përkatësisht zëvendësimi i deriatëhershëm i rrymës letrare, e njohur si klasicizëm me atë të romantizmit. Kjo nënkuptonte edhe bartjen

e interesit kah shtresat e gjera popullore si antipod i asaj se feudalizmi, përkatësisht rendi i tij ishte përqëndruar në promovimin e vlerave, do të kishim thënë artificiale që dilnin nga shtresa aristokrate e cila udhëhiqte me shtetin. Borgjezia e përqëndroi vëmendjen te krijimtaria popullore duke agjitur mbledhjen dhe studimin e asaj që paraqiste “lashtësi popullore”, frymë popullore e të ngjashme, pasi me këtë dëshironte t’u afrohej shtresave të gjera popullore me emrin e të cilave paraqitej në skenën politike.

Përndryshe, vetë fjala “folklor është një fjalë me një histori të shkurtër, por edhe të turbullt. Anglezi i quajtur Xhon Thoms e përdori atë në vitin 1846, për të zëvendësuar sintagmën e papërshtatshme “lashtësi popullore”. Pesë vjet më vonë, paraqitet libri i parë me fjalën “folklor” me titullin e tij *The Dialect and Folk-Lore of North - amptonshire* nga Thomas Sternberg” (Dorson, 1964: 1). Edhe pse fjala *folk*, përkatësisht popull që është pjesë përbërëse e nocionit folkloristikë, por edhe fjala *etnos* që e definon etnologjinë, nisen nga një bashkësi e caktuar dhe më e gjerë njerëzish, studiuesi gjerman Bauzinger, me të drejtë tërheq vërejtjen për dallimin semantik që ekziston mes këtyre fjalëve. Ai shprehet se me nocionin anglosakson *folk* mund të shënohet segmenti shoqëror mes shtresës fshatare dhe asaj industriale, përkatësisht shënon fazën kalimtare kulturore. Në nocionin *popull* çdoherë fshihet pretendimi në ndonjë tërësi shoqërore dhe vazhdimësi kulturore. Përkundrazi, etnologjia që e ka si lëndë kulturrën popullore, është liruar nga fikcioni i trajtave kulturore që vazhdojnë jashta historisë. Ajo sot në shumë aspekte merret me termin shtresa bazike që mund të perceptohet në aspektin shoqëror si shtresa e ulët dhe psikologjikisht si shtresa e thellë dhe etnologjia nuk e kërkon kulturrën popullore vetëm në shprehjet paraindustriale, por edhe në mesin e botës teknike (Rihtman Auguštín, 1988: 23-24). Kur jemi te folkloristika dhe etnologjia duhet cekur edhe faktin se ato njohin rrugë të ndryshme të zhvillimit të tyre në kuadër të shteteve në të cilat janë etabluar si disiplina autonome, apo të pleksura njëra me tjetrën.

Njëtrajtësia kulturore, apo kthimi kah e lashta

Folkloristika dhe etnologjia në filltet e studimit të tyre, por pse jo edhe sot, niseshin nga fakti se kultura popullore ishte e karakterit të njëtrajtshëm, pasi në përgjithësi ajo ishte produkt i periudhës paraindustriale kur pjesa dërmuese e popullatës ishte fshatare dhe e pashkolluar, andaj si rrjedhojë zotëronte edhe kode të njëjta kulturore apo të uniformuara. Në fakt, Herderi, ishte ndër të parët që përdori shprehjen “kulturë popullore” duke e vënë në

kontrast me “kulturën e shkolluar”. Ajo që ishte e re te shpikësit e kulturës popullore, si Herder dhe vëllezërit Grim dhe pasuesit e tyre, ishte “së pari, vënia e theksit te populli dhe së dyti, besimi i tyre se doket, zakonet, ritet, besëtytnitë, baladat, fjalët e urta etj., ishin të gjitha pjesë e një tërësie që reflektonte shpirtin e një kombi të veçantë” (Burke, 1996: 8). Në kohën e paraqitjes së interesimit për kulturën popullore, si rrjedhojë e arsyeve të ndryshme, u paraqit një kult i veçantë ndaj popullit dhe vlerave të tij, andaj intelektualët e identifikonin veten me ta dhe përqipeshin t’i imitonin ata. Në funksion të një përcaktimi të tillë, shkrimtari polak, Adam Çarnocki në vitin 1818 shprehej: “Ne duhet të shkojmë te fshatarët, t’u bëjmë vizita në kasollet e tyre prej kashte, të marrim pjesë në festat, punën dhe argëtimet e tyre. Në tymin që ngritet mbi kokat e tyre, jehojnë ende ritet e lashta, dëgjohen ende këngët e vjetra” (Burke, 1968: 8-9). Pra, interesimi për kulturën popullore ishte pjesë e një lëvizjeje e cila kërkonte, të lashtën, të largtën, përkatësisht burimoren në suazat e kulturës popullore. Me një fjalë, marrja e studiuesit me kulturën popullore, nënkuptonte orientimin e tij vetëm kah e kaluara, përkatësisht kah rrënjët e zhvillimit historik dhe me këtë rast nuk ishin me rëndësi periudhat e mëvonshme historike. Studiuesit gjurmonin pas mitikes së lashtë, përkatësisht kërkohet lidhja me popujt e lashtë, si: ilirët, thrakasit, dakët, sllavët e vjetër, keltët, indoevropianët etj. Kur vërtetohej se një rit, këngë, ose element, qoftë i kulturës shpirtërore, ose materiale ose diçka tjetër e kishte burimin nga populli dhe kur konfirmohej se ai ishte me prejardhje, ta zëmë thrakase, greke, kelte e kështu me radhë, me aluzion ose bindje në vazhdimësi, atëherë hulumtimi ndërpritej. Në frymën e një gjykimi të këtillë që i përfshiu më vonë edhe popujt e Ballkanit, të përkujtojmë se vetëm për baladën me temën e murimit janë shkruar me qindra punime shkencore në të cilat pretendohej, apo përkrahej teza se vendi nga të cilët ishin autorët (studiuesit) ishte burimi i kësaj balade. Nga ana tjetër, Geteja neveritej nga përmbajtja e saj duke theksuar se kishte mbetur thellësisht i tmerruar nga barbaria pagane që buronte nga brendia e baladës në fjalë. Nga vlerësimet e sipërpërmendura, rezulton se etnologjia dhe folkloristika u zhvilluan dhe fituan legjitimitetin e vet në shekullin e XIX, shekull në të cilin u formuan shumica e shteteve kombëtare evropiane, andaj si rrjedhojë e kësaj, kulturat kombëtare, përkatësisht idealizimi i tyre, ishte strumbullari i këtyre disiplinave. Kjo tendencë e tillë u reflektua më vonë negativisht, kurse pikën e saj më ekstreme e arriti në Gjermaninë naziste kur u bë plotësisht nacifikimi i këtyre disiplinave.

Nga ana tjetër, në funksion të asaj që e cekëm më lart, Herderi, vëllezërit Grim dhe pasuesit e tyre, paraprakisht kishin përcaktuar tri pika të veçanta për kulturën popullore, të cilat ishin me shumë ndikim, por njëherit edhe të diskutueshme, nëse analizohen më thellë. Pika e parë e quajtur si *primitivizëm kulturor* bazohej në të dhënë se mosha e këngëve, rrëfimeve dhe festimeve e besimeve ishte shumë e lashtë, përkatësisht e një “periudhe primitive” të papërcaktuar dhe besonin se traditat e parakrishtere ishin transmetuar të pandryshuara për mijëra vjet me radhë. Pika e dytë bazohej në krijimin e këtyre vlerave nga *bashkësia*, përkatësisht populli. Kjo nënkuptonte se në kulturën popullore evropiane më 1800, roli i individit ishte më i vogël, ndërsa roli i traditës, e kaluara e bashkësisë, ishte më e madhe sesa në kulturën e shkolluar, ose të minoritetit të kohës. Pika e tretë që quhej *purizëm* kishte të bënte me bartësit e vlerave kulturore. Sipas autorëve të sipërpërmendur, populli ishin fshatarët të cilët jetonin më pranë natyrës, ata ishin më pak të infektuar nga mënyrat e huaja dhe i kishin ruajtur zakonet primitive më gjatë se çdokush tjetër. Periudha e etnologjisë dhe folkloristikës në fazën fillestare të saj, ndoshta më mirë përshkruhet nëpërmjet një citati që e nxorrëm nga studiuesi gjerman Riehl i cili theksonte: numri më i madh i riteve, apo zakoneve, janë të mira, pasi janë të lashta, e më të lashtat, sipas rregullit, janë më të mirat. Praktikant zakonore, nuk paraqesin ironi të individit, por përmbledhje të urtisë së shumë shekujve. Pasi praktikant zakonore gjatë shekujve ngadalë dhe gradualisht i ka formësuar tërë *qenia popullore*, atëherë ato janë më të vlefshme sesa praktikant zakonore që i formëson individit. Praktikant zakonore, të trashëguara brez pas brezi mund t’i kthjellojmë, më tej t’i mbindërtojë, ose t’i *rrënojmë*, por koha jonë nuk krijon *rite kardinale të kombit*. Kur ritet e lashta të popullit tonë nuk do të ishin aq të mira siç janë, patjetër t’i ruajmë ato dhe t’i mbajmë në jetë, pasi ato përmbajnë në vete *autoritetin* të cilin nëse njëherë e nëpërkëmbim, pastaj *asnjëherë nuk do të mund sërish ta kthejmë*. Vetë kombet rrenohen kur bien ritet e tyre kardinale, pasi me braktisjen e këtyre riteve, mohohet dhe anashkalohet i tërë karakteri i kombit, fuqia e tij më e thellë kulturore. Rënia e regjimit shtëpiak tërheq me vete rënien e regjimit shtetëror” (Rihtman Augustin, 2001: 26). Këto tri koncepte nuk mund të themi se bazoheshin në kritere të shëndosha shkencore, por në frymën e një tendence të këitillë të studimit të kulturës popullore, nuk ekzistonte mundësia e parashtrimit të çështjeve të tjera, për shembull, ta zëmë, ajo për strukturën sociale dhe relacionin e dukurisë etnologjike ndaj asaj strukture,

ose brenda asaj strukture, ose për raportet e gjendjes ekonomike dhe dukurive simbolike në kulturë, ose për ndërveprimin komunikativ dhe për rëndësinë dhe kuptimin e dukurive kulturore, për ndryshimin e tyre e kështu me radhë.

Një tendencë e këitillë e venerimit të kulturës popullore, ishte rrjedhojë edhe e ndikimit të teorisë darviniane të evolucionit biologjik e cila arriti t’i jap gjak të freskët shkencës së re të antropologjisë, por edhe folkloristikës në përgjithësi. Pra, pasuesit e rrugës së Darvinit, folkloristët, thekson Riçard Dorson, kërkuar të rikonstruojnë parahistorinë e njerëzimit nga traditat e njerëzve të egër dhe nga mbijetoja të lashta praktike në mesin e fshatarëve” (Dorson, 1964: 1). Sipas teorisë antropologjike e cila bazohej në evolucionin darvinian, edhe kulturat popullore i nënshtroheshin një logjike të tillë, andaj duhej bërë çmos që ato sa më shpejt të akumuloheshin dhe të publikoheshin dhe të shpëtonin nga harresa, pasi një ditë, me arsimimin e vazhdueshëm të shtresave të gjera popullore, ato do të zhdukeshin. Përveç qasjes antropologjike ndaj kulturës popullore, edhe një qasje tjetër ka qenë e rëndësishme në këtë fushë studimi. Kjo ishte qasja letrare e cila e kundronte folklorin si art të fjalës, përkatësisht merrej me poetikën dhe formën e zhanreve folklorike, stilin dhe variantet folklorike, duke mëtuar të gjejë dhe identifikojë burimet e tyre, të gjejë paralele, apo përkime motivesh në kuadër të popujve të ndryshëm dhe të gjejë variantin bazë, apo rrugën e përhapjes të tij.

Me të drejtë thuhet se një karakteristikë e etnologjisë, apo folkloristikës së shekullit XIX dhe shekullit të kaluar deri kah gjysma e tij, ka qenë oraliteti. Kjo do të thotë se analfabetizmi i shtresave të gjera popullore ka qenë shumë i madh, andaj ka qenë e patjetërsueshme bartja e kulturës popullore, apo më saktë thënë, e vlerave folklorike nëpërmjet mediumit gojor. Karakteristikë e kohës së sotme është shkrimi, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk përhapet edhe më tej nëpërmjet gojës si rrjedhojë e zhvillimit specifik të kombit tonë. “Shumë vepra të letërsisë gojore sot ekzistojnë, përkatësisht funksioni artistik komunikues i tyre është i njëjtë me ato të veprave të shkruara, të natyrës së funksionimit dhe të ndikimit të veprave që krijohen për t’u fiksuar në tekst. Me këtë cilësi, veprat e letërsisë gojore, pra ndërrojnë statusin burimor të funksionimit – komunikimit gojor. Së këndejmi, teksteve të fiksuara të letërsisë gojore u mungojnë, në krahasim me ato që vazhdojnë të funksionojnë nëpërmjet përcjelljes dhe ekzistimit gojor (si akt esencial i jetës së krijimit gojor letrar), pos tjerash, dy karakteristikë që i kanë pasur më parë: a) *funkcioni muzikor i këndimit* (poezia gojore) dhe *funkcioni foljor i rrëfimit* (proza gojore) dhe

b) *ndryshueshmëria e varianteve*, që janë element i rëndësishëm (herë-herë vendimtar) për ekzistencën, pranimin dhe përcjelljen e veprave të letërsisë gojore” (Berisha, 1982: 25).

Shumëtrajtësia kulturore, apo kthimi kah e tanishmja Shoqëria bashkëkohore në të cilën jetojmë është e shkapërderdhur në grupe dhe mënyra të ndryshme të jetesës, gjë që reflektohet edhe në prodhimin e ndryshëm të elementeve kulturore. Në këtë drejtim, Xhulijan Stjuard konsideron se shoqëria bashkëkohore është krejtësisht heterogjene dhe se nuk mund të flitet për një kulturë unike, ose kombëtare, por për nënkultura të cilat mund të veçohen sipas dallimeve lokale, etnike, klasore etj. Klasat më të larta kanë qasje më të madhe në të arriturat kombëtare dhe njëherit nëpër institucione (arsimim më të lartë, inovacione teknologjike, mjekësi të zhvilluar dhe të ngjashme). Me zhvillimin e teknologjisë, rritjen e standardit jetësor dhe përparimin në fushën e komunikimit masiv, këto të arritura bëhen të kapshme për klasat e mesme, kurse në fund edhe për klasat e ulta. Në ndërkohë, zhvillohen shenja të reja kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ato së pari bëhen të kapshme për klasat më të larta (Stjuard, 2002: 87-90). Duhet të përmendet fakti se teoria e dy kulturave ose dy shtresave të kulturës, promovohet fillimisht nga Antonio Gramshi i cili thotë: “populli nuk paraqet bashkësi kulturore homogjene, por në kuadër të tij, paraqiten shtresëzime të shumta e të ndryshme të kombinuara kulturore të cilat jo çdoherë mund të identifikohen si të pastra në disa bashkësi historike popullore”. Ndërkaq, Peter Burke, hipotezën e dy kulturave e çon më tej në shumëstresësinë e kulturave dhe varësinë e ndryshimeve kulturore nga struktura e fuqisë. Kjo nxjerr në shesh pasqyrën shumë të ndërlikuar të kulturës, në të cilën kategoritë e vjetra dhe joshëse etnologjike si për shembull, populli, ritet dhe të kremtet, mënyra e jetesës, ose letërsia popullore, muzika popullore dhe loja, ose burimorja dhe të huazuarat etj., – rrezatojnë në dritë të re... (sipas Rihtman Auguštin, 1988: 49-61).

Venerimit të kulturës popullore nga prizmi i sipërpërmendur, i parapriu fakti se kah vitet e gjashtëdhjeta të shekullit XX, fillojnë të rishqyrtohen nga pozicioni kritik shumë koncepte dhe teori të etnologjisë tradicionale. Në këtë drejtim duhet përmendur etnologjinë kritike gjermane dhe autorët e saj më me zë, si Herman Bauzinger, Ingeborg Veber – Kelerman, Ina - Maria Greverus dhe të tjerë të cilët hapin një faqe të re në etnologji duke u distancuar nga etnologjia romantike e cila kishte humbur betejën me kohën e re. Bauzingeri është një ndër figurat udhëheqëse në kuadër të përfaqësuesve të

folkloristikës që e trajtojnë folklorin sipas funksionit të tij, apo më mirë thënë, në kontekst të ndryshimeve apo transformimeve historike duke u marr para së gjithash me fatin e tij në botën e sotme urbane. Ai i shpall luftë konceptit tradicional, të pranishëm deri atëherë në folkloristikë dhe etnologji i cili bazohej në idealizimin romantik të idilës folklorike, por gjithashtu edhe botëperceptimit se folklori i takon vetëm të kaluarës së vdekur, pa perspektivë të mëtejme. Për këtë orientim apo botëperceptim të autorit flet titulli i një libri të tij *Kultura popullore në botën teknike*. Temat e bashkëkohësisë janë objekt trajtimi edhe në antropologjinë kulturore amerikane. Si tema të cilat janë në epiqendër të preokupimeve të antropologjisë amerikane kulturore janë: hulumtimet etnografike për kuptimin e ndryshëm të punës, proceset e trysnisë dhe rikonfiguracionit të kuptimit të mospajtmimit gjithnjë e në rritje me modelet e vjetra kulturore, sjelljet e reja të ritualizuara të paraqitura në vendin e punës dhe në shtëpi si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve, rëndësitë kulturore të identitetit individual në kontekst të këtyre ndryshimeve e kështu me radhë.

Maskunikimi nuk duhet asesi të anashkalohej, pasi mediumet janë një element i rëndësishëm i përditshmërisë sonë. Në kontekst të hulumtimeve bashkëkohore duhet të analizohet e dhëna se si mediumet e formësojnë një kulturë të caktuar, në çfarë mase ndikojnë në formësimin e përfytyrimeve dhe përvojave të reja. Në kontekst të kësaj duhet vënuar se si një kulturë gojore gjen mënyra për t’u transformuar në kuadër të mediave. Pra, bëhet fjalë për atë se si komunikimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet njësive folklorike kalon në një komunikim të tërthortë nëpërmjet organizimit teknik. Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe bartja e komunikimit të drejtpërdrejtë folklorik në kuadër të emisioneve të ndryshme të mediave. Po ashtu edhe produksioni i gjërë i tregimeve dhe romaneve detektive ose shkencor-fantastike, në shumicën e rasteve, shumë mirë i inkorporuar në stripe, video-seriale, madje edhe në video-lojëra, paraqet një material joshës të studimeve folklorike, përkatësisht të zëvendësimit të zhanreve tradicionale me trajta të reja të komunikimit teknik. Sipas skemës dhe stereotipit, trajtat e reja audio-vizuele, në shumë gjëra ngjasojnë me përmbajtjen e përrallës së lashtë. Individit i pafrikësuar, pas luftës së gjatë, me tensione të shumta, arrin t’i fitoj fuqitë e organizuara të errësirës dhe të arrijë synimin e caktuar. Mënyrë e bartjes së folklorit nëpërmjet teknikës është dytësore dhe nuk është origjinale, andaj ekzistojnë tema të shumta rreth folklorit dhe folklorizmit.

Kultura e internetit në kohën e sotme është shumë e pranishme, andaj logjikisht parashtrohet pyetja sesa hulumtuesi eksploron nëpërmjet internetit, ose bën hulumtimin e këtij medium të ri. Gjithnjë e më shumë ka punime dhe diskutime kushtuar kompjuterit, apo internetit, ose folkloristikës në epokën digjitale. Kur jemi këtu duhet përmendur studiuesin Donald Haaz i cili pandeh se ndikimi më i madh për ndryshimin e hulumtimit të folklorit narrativ tradicional, i referohet, pikërisht internetit. Sipas tij, forma e re e komunikimit paraqitet si rivale shumë serioze e komunikimit gojor në ndërmjetësimin dhe bartjen e vlerave tradicionale narrative. Interneti sot edhe hulumtuesve u ofron një pasuri të madhe të teksteve të zhanreve të ndryshme folklorike, para së gjithash kur janë në pyetje barcoletat e kështu me radhë. Interneti ndjell studiuesin pas bibliografisë, publikimeve të hapura etj. Hulumtimet e deritanishme të internetit kanë qenë të përqëndruara, kryesisht rreth shfrytëzimit të rrjetit dhe mënyrave të komunikimit. Këto hulumtime, gjithashtu mund të orientohen kah problemi i cilësuar, si: realitet / virtualitet, e kështu me radhë.

Etnizimi i kulturës – siç ka theksuar Konrad Kostlin paraqet paradigme etnike të fundit të shekullit XX. Ai thotë: “kah fundi i shekullit XX, etnizimi i kulturës, çoi kah instrumentalizimi i disiplinës. Etnizimi i kulturës ishte, gjithashtu edhe temë në diskutimet lidhur me kritikën e artit që ka të bëjë me “stilet kombëtare”. Etnizimi i kulturës, u bë, papritur shumë i rëndësishëm duke filluar nga radikalizmi i lëvizjeve rajonale dhe nacionaliste e deri te interpretimi politik i “spastrimit etnik”. Ky aspekt, gjithashtu, është i ndërlidhur me dimensionin estetik dhe simbolik të kulturës së definuar etnike (Lafazanovski, 2002: 99).

Kultura urbane. Një kohë të gjatë në kuadër të folkloristikës dhe etnologjisë botërore, ekzistonte një zbrazëti, përkatësisht droja e hulumtimeve empirike në qytet. Këto dy disiplina, pra folkloristika dhe etnologjia ishin profilizuar paraprakisht si disiplina të hulumtimit të kulturës tradicionale në fshat, andaj studiuesit e ndryshën sikur nuk kishin guxim të ndërmerrnin ndonjë hap për të studiuar kulturën popullore në qytet. Megjithatë, disa studiues të dalluar, arritën të futin në përdorim koncepte, si “përditshmëri” (Bauzinger), “stil i jetës” (Burdje) dhe konceptin e habitusit (të cilët në antropologji dhe folkloristikë e futin Ina-Maria Greverus, 1978; Kristijan Xhordano, 1994; Rut Morman, 1990). Këto ishin impulset e para të kthimit të këtyre disiplinave kah qyteti. Pothuajse të gjitha dilemat u zgjidhën kah vitet e 80 dhe 90 të shekullit XX kur përfundimisht përcaktohet fusha e etnologjisë urbane (veçmas në Francë dhe Gjermani, kurse në Amerikë, shkolla e

njohur e Çikagos, shumë më herët në mënyrë më fleksibile i hulumtonte botët urbane në kuadër të antropologjisë kulturore).

Kultura e të rinjve. Hulumtimi etnologjik i lëvizjeve studentore tërheq vërejtjen në problemet që i ka zgjidhur çdo kulturë primare (autentike), por që nuk mund t’i zgjidh qytetërimi bashkëkohor. Faza e rinisë në Evropën moderne zgjat prej pubertetit e kjo do të thotë se ajo fillon prej moshës 24 ose 25 vjeçare kur i riu bëhet i pavarur, martohet apo vazhdon me probleme të tjera. Kjo është një fazë shumë e gjatë sesa në çdo kulturë tjetër primare. Në këtë kohë, njeriu aftësohet për profesionin e tij të ardhshëm, piqet seksualisht, formëson ardhmërinë e tij – por vazhdimisht është i varur ekonomikisht nga prindërit e tij. Andaj nuk duhet të befasojë fakti pse rinia sot ballafaqohet me probleme të shumta që mund të jenë pjesë përbërëse edhe e trajtesave folklorike, ose etnologjike.

Përfundim

Nga krejt kjo që u theksua më lart mund të nxirret konkludimi se folkloristika dhe etnologjia shqiptare, ndoshta edhe më shumë duhet të jenë më vepruese në drejtim të përthithjes së qasjeve të reja metodologjike në studimin e fenomeneve të kulturës popullore që janë pjesë përbërëse e realiteteve tona të ndryshme si rrjedhojë e zhvillimeve të ndryshme historike të qenies sonë kombëtare. Sa u përket elementeve të kulturës popullore, ato në jetën e përditshme hasen në tri trajta të cilat veçohen me vitalitet të dallueshëm. Trajta e parë e kulturës popullore haset si e marginalizuar ose si *mbijetëjë (survival)*, si rrjedhojë e braktisjes së rajoneve fshatare dhe mbipopullimit të qendrave urbane. Trajta e dytë, haset si *kulturë e folklorizuar* aplikative, “e kultivuar”, e cila nën ndikimin e shtetit, pjesërisht ose në masë të madhe është profesionalizuar, stilizuar dhe homogjenizuar. Trajta e tretë paraqet *kulturën e përditshme popullore*, e gjallë, dinamike, si kulturë popullore në jetën bashkëkohore, në të cilën karakteristike janë mobiliteti, qytetet gjithnjë e më të mëdha, industria, teknika e kështu me radhë. Kjo zhvillohet nën ndikimin e globalizmit i cili gjithnjë e më shumë i atakon kulturat tradicionale. Për të tri trajtat e paraqitjes së kulturës popullore, të apostrofuara më lart, është karakteristik fakti se ato nuk janë të veçuara mes tyre, por të ndërlidhura njëra me tjetrën në mënyrë sinkretike.

Studiuesi gjerman, Klaus Rot, duke bërë fjalë për veçoritë e kulturës popullore në shtetet e Evropës Juglindore, thekson se ajo, pra kultura popullore dallohet me tiparin e fleksibilitetit të madh dhe përshtatjes, aftësinë e ndryshimit dhe përvetësimit të

risive dhe përfshirjen e tyre në sistemin ekzistues, d.m.th., aftësinë e *akulturimit* aktiv, ose participimit në vend të imitimit. Autori i njëjtë shton se tradita dhe modernja, atavizmat dhe modernizmat ekzistojnë paralelisht ose së bashku. Modernja evropiane, asnjëherë, nuk ka depërtuar në Evropën Juglindore si një sistem gjithëpërfshirës, por ajo është përvetësuar sipërfaqësisht. Ndryshimet kulturore në Evropën Juglindore, vazhdon Roti, zhvillohen sipas këtyre paradigmave: 1. kryesisht në mënyrë jolineare, përkatësisht periudha e zhvillimit të shpejtë zëvendësohet me stagnim. Kjo do të thotë se zëvendësimi i elementeve të vjetra kulturore me risi nuk ndjek një vijë lineare, apo të njëtrajtëshme. Ndryshimi kulturor është çdoherë një proces i hapur, zhvillim i cili në çdo hapësirë kulturore ka dinamikë tjetër, varësisht nga rrethanat sociale, historike, kulturore etj. Zhvillimi kulturor është i përcaktuar me shumësi të proceseve kundërtëne: përveç urbanizimit rapid ekziston ruralizimi i qyteteve të mëdha, refuzimi i vlerave dhe normave perëndimore, tradicionalizimi i kulturës e kështu me radhë. Edhe përkundër proceseve të shpejta të ndryshimeve sociale dhe ekonomike, edhe përkundër heterogjenitetit, duket se për shkak të veçorive të theksuara të përbashkëta (tradicionaliteti dhe pranimi selektiv i modernes), stili i jetës së përditshme është më homogjen se në Evropën e Mesme dhe Perëndimore. Pra, këto veçori të kulturës popullore, janë pjesë

përbërëse edhe e realitetit shqiptar në përgjithësi, andaj studimi i tyre sipas qasjeve të reja metodologjike e teorike, do të ndikonte që etnologjia dhe folkloristika shqiptare të inkuadroheshin në vorbullin e kohës në të cilën jetojmë, e përmbushur me përplot kundërtënie e paradokse kulturore. “Njerëzit më tepër janë bij të kohës së vet sesa të etërve të tyre” thoshte me të drejtë historiani Mark Bloh.

Bibliografia

- BERISHA, Anton (1982): *Çështje të letërsisë gojore*. „Rilindja“. Prishtinë.
- BURKE, Peter (1996): *Kultura popullore në Evropë në fillimet e Kohës së Re*. “Arbri”. Tiranë.
- DORSON, M. Richard (1964): *American Folklore*. The University of Chicago Press. Chicago and London.
- DUSHI, Arbnora (2006): Folklori dhe folklorizmi në periudhën post-socialiste. *Gjurmime albanologjike. Folklor dhe etnologji. 35-2005*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.
- GEERTZ, Clifford (1973): *The Interpretation of Cultures*. Basic Books. New York.
- KOKJARA, Đuzepe (1985): *Istorijska folklorika u Evropi*. Biblioteka XX vek. Beograd.
- RIHTMAN AUGUŠTIN, Dunja (2001): *Etnologija i etnomit*. Zagreb.
- ROT, Klaus (2000): *Slike u glavama. Ogledi o narodnoj kulturi u jugoistočnoj Evropi*. Biblioteka XX vek. Beograd.